



Republika e Kosovës  
Republika Kosova –  
Republika of Kosovo  
**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality  
of Prishtina



<b>Datë/a:</b>	07.06.2018.
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.06.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me Nr. të Prok: 616 18 007 111 nxjerr:

## VENDIM

1. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. e parashtruar me datë: 06.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me Nr. të Prok: 616 18 007 111, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK -së, të datës 31.05.2018 të publikuar në web-faqe te KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me Nr. të Prok: 616 18 007 111 dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës ;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 16.05.2017 ka pranuar vendimin nga Organi Shqyrtues i Prokurimit pas ankesës së parashtruar nga OE: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me tenderin me titull: "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me Nr. të Prok: 616 18 007 111. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) konstaton pranimin e ankesës së Operatorit Ekonomik të lartcekur dhe rikthen lëndën në rivlerësim si dhe udhëzon Operatorin Ekonomik që ti përmbahet kriterëve të dosjes së tenderit. Me datë 04.06.2018 përfaqësuesi i OE: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. ka pasur çasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar fitues. Operatori Ekonomik ankimor ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 06.06.2018 tek Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës.

### I. Baza Ligjore për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim

Operatori Ekonomik: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 06.06.2018, në ora 17:15pm të dorëzuar në mënyrë elektronike.

#### **Provë 1: Kërkesa për Rishqyrtim - datë 06.06.2018**

Autoriteti Kontraktues me datë 28.05.2018 iu ka dërguar letrat standarde i sukseshëm, i pasukseshëm, i eliminuar OE ekonomik, ndërsa me datë 28.05.2018 ka bërë njoftimin për dhënie për kontratë, ndërsa Njoftimi për Dhënie të Kontratës është shpallur me datë 31.05.2018.

**Provë 2: Letër Standarde për OE ankimor dhe OE të rekomanduar për dhënie të kontratës**  
**Provë 3: Njoftimi për dhënie të kontratës - 31.05.2018.**

Me datë 05.06.2018, Operatori Ekonomik ka bërë Ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit kundër AK dhe të njëjtën e ka dorëzuar në mënyrë elektronike tek Autoriteti Kontraktues duke shkelur të drejtën për shfrytëzimin e mjetit të rregullt juridik në shkallë të parë dhe duke mos precizuar ankesën në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

**Provë 4: Ankesa e dorëzuar në mënyrë elektronike me datë: 05.06.2018, në ora 15:08.**

Autoriteti Kontraktues menjëherë pasi ka vërejtur që ankesa nuk është precizuar ka njoftuar OE ekonomik ankimor që të precizojnë ankesën dhe pas njoftimit të AK, OE ankimor ka bërë precizimin e ankesës me datë 06.06.2018 të dorëzuar në mënyrë elektronike në ora: 17:15pm.

## II. Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve , par 3. i cili thekson:

*"3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

*3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankesit".*

Operatori Ekonomik ankimor ka pranuar letrën standarde për tender i pasukseshëm me datë 28.05.2018, si dhe Publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës 31.05.2018. Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që në ditën e 6-të ka parashtruar ankesë të precizuar pra me datë 06.06.2018 edhe pse afat ka pasur vetëm deri me datë 05.06.2018.

Gjithashtu Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/a në par.8. dhe 8.1. thekson:

*"8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:*

*8.1. kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni"*

Poashtu në rast të mospërputhjes së datave lidhur me letrën standarde për tender i pasukseshëm dhe njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me rrjedhjen e afatit për parashtrimin e kërkesës për Ri-shqyrtim ne Udhëzuesin Operativ për Rregullat e Prokurimit Publik në nenin 22 par.3 thekson:

*Në përputhje me nenin 4, par.4.2. të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e publikimit duhet të jetë e njëjtë me datën kur AK e njofton OE dhe në rast të mospërputhjes së datave, mbizotëron data kur njoftimi me shkrim i dërgohet Operatorit Ekonomik.*

Në këtë rast OE ankimor prapë ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për ri-shqyrtim pasi që letrën standarde për tenderuesin e pasukseshëm e ka marrë me datë 28.05.2018, ndërsa kërkesa për ri-shqyrtim është parashtruar me datë 06.06.2018 që dë të thotë është humbur afati ligjor (ius strictum).

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

